Kronikë

Shpërthimi i tritolit mbrëmë në Durrës, dyqani në pronësi të efektivit të Forcave Shqiponja, dyshohet për shkak të detyrës! Familjarët: S'kemi konflikte

Dyqani që iu vu tritoli mbrëmjen e djeshme në Durrës, rezulton në pronësi të efektivit të Forcave Shqiponja, Hysen Gashi. Paraprakisht dyshohet se shkak për ngjarjen është bërë detyra e Gashit.

Redaksia
23 Prill, 09:19 | Përditesimi i fundit: 23 Prill, 09:53

Dyqani që iu vu ***tritoli*** mbrëmjen e djeshme në Durrës, rezulton në pronësi të efektivit të Forcave Shqiponja, Hysen Gashi. Policia s'ka ende asnjë të dyshuar por shkak për ngjarjen dyshohet të jetë puna e efektivit. Familjarët kanë deklaruar se nuk kanë konflikte me asnjë.

Ngjarja ndodhi rreth orës 22:20 mbrëmë, në fshatin Katund i të Ri, ndërsa tritoli, një sasi e vogël, u vendos në qepenin e derës së jashtme të dyqanit. Nga shpërthimi fatmirësisht pati vetëm materiale, teksa ngjitur me dyqanin ndodhet edhe banesa e familjes Gashi, por në momentin e shpërthimit nuk ndodheshin në shtëpi.

LEXO EDHE:
Lungomare në Plazhin e Durrësit, 3 km shëtitore me parqe, Rama: Një Shqiponjë në mes të detit, si Palma në Dubai! Mos të thonë më durrsakët që mbetëm pas Vlorës

Për ngjarjen nuk bëhen me dije të tjera detaje, teksa policia ka nisur hetimet.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:55
Iu vu tritoli në dyqan, vëllai i efektivit të policisë: Autorët mbështeten diku meqë janë kaq trima, ne nuk kemi vrarë e rrahur njeri

Vëllai i efektivit të policisë Hysen Gashi, dyqanit të të cilit iu vu ***tritoli*** mbrëmjen e djeshme në Durrës ka folur para mediave duke thënë se ngjarja mund të ketë ardhur vetëm prej detyrës pasi nuk kanë pasur konflikte me askënd. Sipas tij, nuk ka asnjë person të cilit mund t'ia vënë gishtin, por supozon që kushdo që ka guxuar të vendosë sasinë e tritolit të ketë mbështetje, ndaj bën thirrje për drejtësi.

> *"Nuk kemi vrarë as kemi rrahur këmd. Kjo vetëm për shkak të detyrës, s'ma merr mendja për gjë tjetër.*
>
> *Kohët e fundit e ka përdorur si magazinë ndërsa më parë e ka pasur dyqan. Ka shitur rroba. Bënte gruaja tregti. Policia ka ardhur menjëherë, ka qenë ora rreth 10:30. Zona nuk ka qenë e ndriçuar. Kamera sigurie i ka vendosur por nuk i ka në funksion. Tek lokali i ka marrë policia, kurse këta nuk kanë pasur kamera sigurie.*
>
> *Kjo është rrugë, nuk mund t'i vendosësh gishtin askujt po nuk pe gjë. Kjo punë ka ardhur vetëm se është polic, ka ndonjë që i ka ngelur hatri, cfarë t'i bësh. Pasi nuk është bërë dëm në njerëz, dëmeve materiale nuk kemi cfarë t'i bëjmë. Ishalla bëhet drejtësi, por kam frikë se këta që i bëjnë këta punë, mbështeten diku që janë kaq trima se unë për veten time nuk i bëj keq njeriu.*
>
> *Nuk ka pasur njeri tek shtëpia fare. Hyseni ka qenë në punë, ka 30 vjet që është polic në Durrës me Shqiponjat. Gruaja ka qenë tek vajza për darkë në Rrushbull. Kjo punë ka ndodhur rreth orës 10:20, Hyseni ka qenë duke u kthyer nga puna.*
>
> *Unë e pyeta Hysenin, i thashë ke ndonjë ngatërresë kohët e fundit, tha policë jemi, në qafë nuk i kapim njerëzit", tha vëllai i Hysen Gashit.*

J.SH./Shqiptarja.com

TAG: hysen gashi | tritol | Durres

Komento

Komente

Huy: 23/04/2022 10:59
Azil te mbare mor bir.

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni proçesin për zgjedhjen e Presidentit të ri?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Shpërthen tritol në derën e jashtme të një dyqani në Durrës, vetëm dëme materiale, ende s'dihen rrethanat
22 Prill, 23:46

Sociale

S'ka fuqi punëtore në Durrës, operatorët turistikë: Po marrim punonjës nga Azia, Kosova, Serbia e Maqedonia, të huajt zënë 30% të të punësuarve
22 Prill, 21:03

Kronikë

Ministri i Brendshëm mbledh drejtorët e 5 qarqeve, në fokus diskutimet për 'luftën' kundër kanabisit
22 Prill, 10:43

Kronikë

Luftë kultivimit të drogës, mblidhen drejtorët e 5 qarqeve! FNSH blindon Krujën, 72 orë kontrolle antidrogë në zonë! Sekuestrohen 400 fidanë kanabis! (VIDEO)
22 Prill, 09:34

Kronikë

20-vjeçari humbi jetën duke punuar në portin e Durrësit, e ëma kërkon drejtësi: Të më tregojnë çfarë i ndodhi djalit tim! Kompania ku pononte po tenton ta manipulojë ngjarjen
21 Prill, 14:34

Kronikë

94 fermerëve të duhanit u faturohet krom, Prokuroria e Durrësit mban 'peng' dosjen! Në skenë Xhevdet Hyseni që akuzohet për pastrim parash e fatura fiktive, një magazinë 'krimi' në Kavajë
Adriatik Doci
21 Prill, 10:45

Kultura

Ben Blushi: Jonuz Selimi me fytyrën e Pablo Picassos
Ben Blushi
21 Prill, 10:38

Kultura

Metateatër e komedi arti! 'Princesha e Dyrrahut' me personazhe historikë e dritëhijet e aktualitetit social e politik, regjisori Doda: Është realiteti ynë, duhet të flasim
Anila Dedaj
20 Prill, 16:35

Kronikë

U shanë në rrjetet sociale, 22-vjeçari merr peng të riun në Fushë-Krujë! E çon në një pyll në Krastë dhe e dhunon
20 Prill, 11:33

Ekonomi

Ankorohet anija turke në portin e Durrësit, solli grurë nga Ukraina për Kosovën
19 Prill, 13:55

Kronikë

19-vjeçari humbi jetën teksa po punonte në Portin e Durrësit, lihen në burg 3 punonjësit e firmës së përpunimit të konteinerëve
19 Prill, 10:49

Kronikë

Ankorohet në portin e Durrësit fregata 'Aconit' e Marinës Franceze, stërvitje me Forcat Detare Shqiptare
19 Prill, 10:32

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton